



## **Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”**

### **Fakulteti Filozofik**

### **Departamenti i Historisë**

#### **Rezyme e punimit: “Pasojat e luftës Ruso-Osmane 1877-1878 për Shqiptarët ”**

“Pasojat e luftës Ruso-Osmane 1877-1878 për Shqiptarët”si temë për plotësimin e pjesshëm të obligimeve për të fituar titullin Master i Historisë - Koha e Re.

Në historografinë shqiptare është njëra ndër temat më të ndjeshme edhe, për popullin shqiptar më tragjike, më me pasoja të jashtëzakonshme, që nga Kriza Lindore padyshim ishte dhe është edhe problematika e Muhaxhirëve të Sanxhakut të Nishit-Toplicës, si për nga përmasat ashtu edhe për nga brutaliteti, është më e ndjeshmja, ndaj, edhe në studimet historike, vazhdimisht, kërkon trajtim të veçantë. Sanxhaku i Nishit - Toplica hynë në radhën e krahinave të mëdha të gjeografisë së Shqipërisë natyrale, vazhdimësi e Dardanisë antike ishte territori kompakt i Shqipërisë natyrale deri në vitin 1877-1878, kur u bë pre gllabëruese e Serbisë së Mbretërisë së Obrenoviqëve. Gjatë viteve 1877 dhe 1878, pra, gjatë luftës ruso-turke e më pas serbo-turke. Serbia me dhunë dhe me një gjenocid të paparë e shpërnguli popullatën shqiptare nga këto troje iliro-shqiptare. Ishte fillimi i zbatimit të planit famëkeq, Projektit të Ilia Garashaninit (1844), plan i cili, parashihte zgjerimin territorial të Serbisë, pushtimet e reja, në dëm të tokave shqiptare. Serbia, me politikën e saj ekspansioniste, në radhë të parë dhe drejtpërdrejtë ndaj tokave shqiptare, për mrekulli e shfrytëzoi situatën ndërkombëtare të krijuar me rastin e luftërave të sipërshënuara si dhe të rrethanave politike dhe ushtarake të cilat ishin në Ballkan dhe në Evropë. Brenda një kohe disa mujore nga trojet stërgjyshore u shpërngulën me dhunë 714 vendbanime - fshatra shqiptare me një popullësi prej treqindmijë banorësh, banor autokton që nga parahistoria. Popullata shqiptare e dëbuar nga vatrat e tyre shekullore u vendos në vende të ndryshme si në Kosovë e deri në Turqinë e largët. Por, numri më i madh u vendos në Kosovë, si vendi më i afërt dhe shpresë për kthim, gjë e cila ishte gjithëherë dëshirë e popullatës muhaxhirëve. Kjo popullatë u ballafaqua me sfida nga më të ndryshmet si: sigurimi i strehimit, sigurimi i ushqimit, sëmundjet, shqetësimet emocionale, krimet që i kishin parë gjatë dëbimit e që ju rrinin në kokë si shpata e Demokleut. Mbi të gjitha, integrimi i tyre në popullatën vendase, pra, në vendet, hapësirat gjeografike ku kishin migruar, shtegtuar, po ashtu, ishte popullatë shumë e varfër.

Tema studimore, të cilën e trajtoj, vërtet është temë komplekse, jo edhe aq e lehtë për t'u hulumtuar, mbarështruar ngase, integrimi i një popullate, e cila dëbohet dhunshëm nga trojet e

veta, si në rastin e shqiptarëve, Muhaxhirëve të Nishit – Toplicës, është shumë dimensionale, përfshinte aspekte nga më të ndryshmet, si: traditat, zejet, shkollimi edhe pse ishte shumë i pakët e kryesisht ishte fetar, tentimi për integrimin me popullatën vendase etj. Megjithatë, siç del nga burimet arkivore, popullata, Muhaxhirët e Nishit - Toplicës ishte shumë punëtore dhe shumë shpejt arriti të gjejë vetën në një realitet të ri. Realiteti megjithatë ishte ambient shqiptar dhe ishte paksa më relaksues në raport me tërë atë katrahur që përjetuan gjatë dëbimit dhe përndjekjes. Menjëherë, filluan të ndërtojnë shtëpi, në fakt, kasolla banimi gjysmë në dhe , nga banorët vendas quheshin koliba që paksa thuhej me ofendime, por edhe populli vendas i quante këta banorë shpesh kolibagji. Por, për një kohë ata u avansuan dhe paksa u modernizuan në raport me kohën. Odat e ndejës për burrat i sollën ata sepse kjo dhomë pritje duhej të jetë e veçantë meqenëse aty kuvendohej për tema nga më të ndryshmet dhe duhej të ishte më larg se shtëpia e banimit që përdorej nga banorët tjerë të shtëpisë, pra, gratë e fëmijët.

Pamja e oborrit të shtëpisë ishte disi më e veçantë për kohën. Filluan të punojnë zejet e tyre të preferuara dhe të përdorura edhe në vendlindje të cilat ishin burim i jetesës së tyre. Në popullatën vendase risitë të cilat i solli ajo popullatë shqiptare ishin të shumta dhe shumë atraktive për fillim për banorët vendas. Veshja paksa më specifike, rregullimi shtëpiak, oborret e shtëpive, ndejat, miqësit, gazmendet familjare, vdekjet, pritjet pas vdekjes. Shoqërimi më specifik, që në fillim bëhej më shumë vetëm brenda komunitetit të tyre, dalngadalë u tejkalua dhe filluan shoqërimet dhe miqësit me vendasit. Ushqimet të cilat, ajo popullatë shqiptare i përdornin në fillim ishin përgatitja e patates, që në fillim nga vendasit më shumë vetëm pjekej por jo edhe gjellë, ngrënia e domatës vetëm e papjekur dhe për turshi, por nuk përdorej i pjekur sepse në fillim cilësohej si i kalbur dhe i ndaluar për ngrënie, gatimet e ushqimet tradicionale, si flija, specialitet kombëtar, konzervimi i ushqimeve për dimër, përgatitja e mishit, terja e tij dhe konzervimi për dimër, përgatitja e disa specialiteteve prej mishi etj. E veçanta e tyre në integrim pa dyshim ishte mentaliteti i tyre që për shumë nuanca dallonte në raport me mentalitetin vendas, kuptohet mentaliteti i muhaxhirëve ishte paksa më i avansuar në raport me kohën, për arsye se kjo popullatë në vendlindje ishte në një udhëkryq rrugor që ishte në kontakt me kultura të ndryshme. Shtjellimi i gjithë këtyre temave që lidhen me aspektin e integritit qartësojnë në masë të madhe problematikën e kësaj popullate në raport me integrimin e tyre në hapësirën e re gjeografike për ata, pra përshtatjen në rrethanat e reja shoqërore, sociale, kulturore si dhe politike, kombëtare. :

Duke përfshi temën që nga Kriza lindore 1875-1878 kam trajtuar rrethanat politiko-ushtarake të Perandorisë Osmane në gjysmëne dytë të shekullit XIX, Sanxhakun e Nishit si territor gjeografik të etnikumit shqiptar, popullsinë e saj, numrin e banorëve, kulturën, traditën, doket dhe zakonet e kësaj ane, shpërnguljen e dhunshme, përmasat e gjenocidit, pasojat e kësaj shpërngulje për vet popullatën e dëbuar si dhe dëmin në nivel kombëtar, fillimisht rrethanat e përgjithëshme politike në Ballkan, në prag të fillimit të luftës Ruso- Osmane, për arsyet të cilat çuan deri te shpërthimi i Krizës Lindore, e cila, edhe për çështjen shqiptare ishte strumbullar kryesor dhe determinuese për zhvillimet e mëtejshme. Me një shtjellim ndërlidhet kryengritja në Hercegovinë, duke vënë theksin tek zhvillimet qendrore të periudhës së fillimit të Krizës Lindore 1875 – 1878. Një hapësir

dhe vëmendje të veçantë, i kushton Lëvizjës sonë Kombëtare, veprimtarisë së patriotëve shqiptarë, gjatë luftërave Serbo- Osmane e Malazeze – Osmane 1876 -1878. Në këtë rrafsh me burime historike, trajton pozitën e popullit shqiptar në gjithë ato zhvillime, tejet dramatike, si në fushën ushtarake të luftës ashtu edhe në atë diplomatike, ku shqiptarët, jo vetëm që nuk ishin faktor, por,ishin të lënë pa përkrahje. Në lidhje me qëndrimin e popullit shqiptar ndaj luftërave Serbe – Osmane dhe Malazeze – Osmane.

Në këtë pjesë merrem me trajtimin e luftës Ruso-Osmane, e cila pati ndikime, pasoja , në radhë të parë për popullin shqiptarë, dhe pozicioni i Ruisë Cariste ishte përforcuar dhe objektivat e saja në Ballkan, po realizoheshin, sidomos në dëm të çështjes sonë shqiptare. Në vijim, japim disa nga arsyetimet më thelbësore të fillimit të luftës së viteve 1875 – 1878. Më tej, me një fokus të veçantë përqëndrohem te çështja shqiptare dhe Paqja e Shën Stefanit, e datës 3 mars 1878, e cila, duke favorizuar aleatët e Ruisë Cariste, Malin e Zi dhe Serbinë, e dëmtonte rëndë çështjen tonë shqiptare. Pavarësisht se, Serbia dhe Mali i Zi, në dukje të parë, u paraqitën të pakënaqura me vendimet e Marrëveshjes së Shën Stefanit, megjithatë, ato dolën fitimtare, dhe nxorrën përfitime në dëm të popullit shqiptar ndaj tokave shqiptare. Këtë konkludim, e them me mjaft argumente dhe vlerësime objektive edhe kur flas për pretendimet territoriale të Serbisë, në prag të marrëveshjes së Shën Stefanit. Reagimit të krerëve të atëhershëm shqiptarë, reagim i cili ishte i pafuqishëm, sepse nuk e kishte përkrahjen e asnjë Fuqi evropiane. Megjithatë, mund të konstatohet se, në ato vlime të rëndësishme të një etape të re të historisë së Ballkanit, kur Perandoria Osmane, e mundur , po tërhiqej, krerët e Lëvizjës sonë Kombëtare u organizuan dhe e ngritën zërin tonë kombëtar para kançelarive evropiane. Ishin ato vetëm reagime, të cilat nuk kishin përkrahjen e diplomacisë së kohës, aq më pak, të Perandorisë Osmane, e cila, në Konferencat ndërkombëtare, siç ishte, Paqja e Shën Stefanit, Kongresi i Berlinit, si dhe në shumë takime të diplomatëve turqë me ata rusë, serbë, malazez, bullgar etj, në asnjë rast nuk i doli në mbështetje të drejtës së popullit shqiptar. Prandaj, Serbia dhe Mali i Zi, të përkrahura nga Rusia Cariste, e kishin më të lehtë, që t'i pushtojnë tokat shqiptare. Madje, flota turke, u kishte dalë në ndihmë flotës luftarake të Malit të Zi për ta pushtuar Ulqinin. Në historinë e Ballkanit, përherë të trazuar, nuk ka rast më tragjik, se sa ai i popullit shqiptar, të cilit, përmes Paqës së Shën Stefanit dhe Kongresit të Berlinit, pra, në diplomacinë evropiane, u morën territore me mijëra kilometra. Diplomacia evropiane, i përkrahu dhe i zbatoi kërkesat e Serbisë dhe të Malit të Zi për pushtimin e tokave shqiptare. Perandoria Osmane, në tërheqje e sipër nga Ballkani, e mundur, e sëmura e Bosforit, as që ndërmerri ndonjë veprim diplomatike apo ushtarake për ta mbrojtur popullin shqiptar. Por, aso kohe, në ato vitet e vetmisë së madhe, ne nuk kishim organizim të duhur as diplomatik., ushtarak e as kombëtar për t'i ruajtur tokat tona!

Në këtë pjesë trajtojmë kërkesat e Serbisë, paraqitur në Kongresin e Berlinit për zgjerimet territoriale në tokat shqiptare. Me këtë rast, nga punimet dhe nga vendimet e Kngresit të Berlinit, të cilat ishin në favor të kërkësive ekspansioniste të Serbisë dhe të Malit të Zi, dhe në dëm të së drejtës historike, etnike të popullit shqiptar. Lidhur me këtë, argumente duke iu referuar disa dokumenteve kryesore të kohës, atyre të viteve 1878 – 1879, që kishin paraparë coëptimin e

tokave shqiptare. Në ato plane, dokumentohen pretendimet, synimet serbe dhe malazeze për copëtimin e bregdetit shqiptar. Më tej, bëme analizë pozitive, veprimet, por edhe sfidat e mëdha të popullit shqiptar në fillim të Krizës Lindore 1875 – 1876. Me theks të veçantë, përqendrohemi në pasojat e Kongresit të Berlinit për popullin shqiptar gjithandej. Në të njëjtin kapitull shqyrtojmë edhe lëvizjet e popullsisë myslimane në Ballkan.

Në këtë pjesë trajtojmë, shqyrtojmë pushtimin e Sanxhakut të Nishit në rajonin e Toplicës nga forcat serbe, pastaj luftimet e shqiptarëve të Toplicës, Kazanë e Kurshumlisë, si dhe motivet kryesore historike, të shpërnguljes së shqiptarëve të Sanxhakut të Nishit. Në historinë e hidhur të shqiptarëve të Sanxhakut të Nishit, Toplicës, Kurshumlisë, përballë planeve të ushtrisë serbe për dëbimin e shqiptarve në vitet 1877-1878, si pasojë e politikës ekspansioniste serbe, por edhe si rezultat i vendimeve të padrejta të Kongresit të Berlinit. Një trajtim të veçantë, ishte vendosja e Muhaxhirëve nëpër qendrat e ndryshme të Vilajetit të Kosovës, vendosje me plot sfida dhe mjerim dhe tejet pikëlluese të dëbimit të shqiptarve nga ato vendbanime të tyre shekullore, përpjekjes së tyre për tu përshtatur me kushtet në Vilajetin e Kosovës, si dhe themelimin e Muhaxherëve. Marshimi i ushtrive serb dhe atyre malazeze në Kosovë, drejt Plavës dhe Gucisë si dhe rezistenca e shqiptarve, janë pasqyruar me mjaft elemente argumentuese. Pa dyshim Lidhja e Prizrenit, roli i saj, jehona në qarqet e ndryshme të Evropës, janë tejet të rëndësishme. Edhe qëndrimi i diplomacisë evropiane dhe ai i shtypit evropian ndaj Lidhjes së Prizrenit, janë me interes për çështjen kombëtare. Të jemi objektiv në shqyrtimin e kësaj nënteme, duke mos e glorifikuar sidomos, rolin, rezultatet kombëtare të Lidhjes së Prizrenit. Është me interes edhe trajtimi i çështjes së reagimeve të Perandorisë Osmane ndaj Lidhjes së Prizrenit, të cilën, siç shihet nuk e përkrahu, përkundrazi, kërret e saj i burgosi dhe i detyroi të syrgjynosen.

**Msc. Mehmet Shala**